



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.25, datë 30.01.2023

PËR

“PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRAT TË PROFILIT PROKUROR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 29 pika 1 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 166 pika 2, 183 pika 1 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Numri maksimal i kandidatëve për magjistratë të profilit prokuror që do të pranohen në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024 është 40 (dyzetë).
2. Raporti i përqindjeve të kuotave të kandidatëve për magjistrat të kërkuar nga Këshillat, të mbetet i pandryshuar pavarësisht nga numri i kandidatëve të pranuar nga Shkolla e Magjistraturës.
3. Të njoftohet për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 30.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR

Alfred Balla

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Eloida Goxhi

ANËTAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Bujar Sheshi

ANËTAR

Esmeralda Keshi

ANËTAR

Arta Mandro

ZV/KRYETAR

Tartar Bazaj

ANËTAR

Nurihan Seiti

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Ledina Riza